



South East European Network
for Professionalization of Media

ZGJERIMI I PEIZAZHIT MEDIAL, PËRKEQËSIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE DHE EDUKIMI I ULËT MEDIAL

E ardhmja e mediave në Kosovë
– Fakte dhe trende

Jeton Mehmeti

MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median
dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut

MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut

**ZGJERIMI I PEIZAZHIT MEDIAL, PËRKEQËSIMI I SIGURISË
SË GAZETARËVE DHE EDUKIMI I ULËT MEDIAL**

E ardhmja e mediave në Kosovë – Fakte dhe trende

Autor: Jeton Mehmeti

Redaktore, hulumtuese kryesore rajonale: Brankica Petković

Redaktore gjuhësore: Nora Behluli

Përkthyes: Qerim Ondozi

Dizajn: Špela Kranjec

Botues:

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Fondacioni "Mediacentar", Sarajevë

Kosovë, janar 2025



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova



*Botimi u krye me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian.
Përmbytja e tij është përgjegjësia e vetme e autorit dhe botuesve
dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pozicionin e Bashkimit Europian.*

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	6
II. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	9
III. TË VENDITE ARDHMJA E GAZETARISË	11
IV. E ARDHMJA E MEDIAVE	14
4.1. KONCEPTI I MEDIAVE	14
4.2. PEIZAZHI MEDIAL	15
4.3. PRONËSIA E MEDIAVE	17
4.4. FINANCIMI I MEDIAVE	18
4.5. PËRFAQËSIMI NË MEDIA	19
4.6. PJESEMARRJA NË MEDIA	21
V. E ARDHMJA E PËRDORIMIT TË MEDIAVE DHE BESIMI	22
5.1. PËRDORIMI I MEDIAVE	22
5.2. BESIMI NË MEDIA	24
VI. E ARDHMJA E DEMOKRACISË	25
VII. PËRFUNDIME	28
LITERATURA DHE BURIMET	29
PËR AUTORIN	32

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Regjistrimi i popullsisë në Kosovë i vitit 2024 tregon se ka më pak njerëz në Kosovë në krahasim me një dekadë më parë. Megjithatë, mosha mesatare e popullsisë, aktualisht 34 vjeç, është relativisht e re, gjë që shpjegon përdorimin masiv të mediave sociale si mjet informimi dhe komunikimi. Edhe pse televizioni mbetet burimi kryesor i informimit, mediat sociale, veçanërisht Facebooku dhe Instagrami, ngadalë po bëhen burime alternative të informimit. Ky hulumtim synon të analizojë trendet e ndryshueshme në përdorimin e mediave dhe besimin në media në Kosovë. Kjo pjesë përmbledh trendet kryesore që prekin gazetarinë, mediat dhe demokracinë në vend.

Edhe pse televizioni mbetet burimi kryesor i informimit, mediat sociale, veçanërisht Facebooku dhe Instagrami, ngadalë po bëhen burime alternative të informimit.

- Numri i studentëve të gazetarisë dhe komunikimit në Universitetin e Prishtinës ka mbetur i njëjtë në tre vitet e fundit. Departamenti i Gazetarisë kishte 250 studentë në vitin 2023/2024. Dy kolegje të tjera private ofrojnë studime të gazetarisë, por numri i studentëve të tyre nuk është në dispozicion.

- Numri i gazetarëve është rritur në vitet e fundit. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka 720 anëtarë, përfshirë gazetarë, operatorë kamerash dhe gazetarë të pavarur. Shumica e anëtarëve (65%) janë gra. Megjithatë anëtarësimi po rritet, formimi i sindikatave ose të qenët pjesë e sindikatave nuk është diçka e popullarizuar në mesin e gazetarëve në vend.

- Numri i sulmeve të regjistruara dhe shkeljeve të të drejtave të gazetarëve është rritur në vitet e fundit. Gjithsej 74 raste u raportuan në vitin 2023, që është dy herë më shumë krahasuar me vitin 2022.

- Rregullimi në nivel nacional në sektorin e mediave nuk është përditësuar që nga viti 2012. Një përpjekje u bë në vitin 2024 kur një ligj i ri për mediat u miratua në Kuvend, por ai u kundërshtua në gjykata. Ligji i kontestuar ofron përkufizime të reja të llojeve të ndryshme të mediave (platforma online, transmetuese, për shpërndarjen e videove, video sipas kërkesës).

- Numri i mediave online të lajmeve është rritur, sikurse edhe numri i stacioneve televizive. Megjithatë, një trend negativ i ka prekur mediat e shtypura. Asnjë gazetë ose revistë ditore ose javore nuk botohet në vend.

- Në Kosovë rregullohet transparenca mediale e pronësisë së mediave transmetuese, sikurse edhe përqendrimi i mediave. Më pak informata mbi pronësinë e mediave është në dispozicion për mediat online.

- Vlera e tregut të reklamave është e vogël për numrin e madh të mediave. Të dhënat e fundit tregojnë se vlera totale është 15 milionë euro. Televizioni ende ka hisen më të madhe në vlerën e tregut vendor të reklamave, por pjesa e mediave online është rritur.

- Financimi i mediave nga buxheti publik nuk është i rregulluar në mënyrë specifike. Transmetuesi i shërbimit publik merr më shumë se 90% të buxhetit të vet nga shteti. Mediat e komunitetit ndonjëherë marrin para publike përmes subvencioneve dhe granteve.

- Transmetuesi i shërbimit publik cakton kohë në programimin e vet për grupet minoritare. Të gjitha pakicat etnike të njohura kanë programet e tyre në produksionin e transmetuesit publik.

- Në vitin 2023, televizioni ende kishte audiencën më të madhe, por mediat online dhe rrjetet sociale po e rrisin shtrirjen e tyre, veçanërisht të rinjtë. Facebooku, Instagrami dhe TikTok janë platformat më të përdorura për shpërndarjen e videove.

- Kosova është pothuajse në vendin e fundit kur bëhet fjalë për renditjen në Indeksin e Edukimit Medial në mesin e vendeve evropiane. Në vitin 2023, ajo u rendit në vendin e 40-të në një listë prej 41 shtetesh.

- Indeksi i Demokracisë, Indeksi i Sundimit të Ligjit dhe Indeksi i Lirisë së Mediave janë përmirësuar, por niveli i Indeksit të Korrupsionit të Perceptuar mbetet pothuajse i njëjtë.

- Mungojnë të dhënat kryesore për mediat dhe gazetarinë, veçanërisht për sa i përket audiencës dhe analizës së tregut.

Kosova është pothuajse në vendin e fundit kur bëhet fjalë për renditjen në Indeksin e Edukimit Medial në mesin e vendeve evropiane. Në vitin 2023, ajo u rendit në vendin e 40-të në një listë prej 41 shtetesh.

I.

HYRJE

Ky raport ofron një përshkrim të shkurtër narrativ dhe analizë të një grupi të gjerë të dhënash. Duke përdorur tregues të ndryshëm mbi mediat dhe zhvillimin e demokracisë, ne synojmë të krijojmë të kuptuarit më të mirë të së ardhmes së mediave në vend. Grupi i të dhënave është i ndarë në pesë seksione kryesore, gjegjësisht të dhënat e përgjithshme për Kosovën, të dhënat për gazetarinë, të dhënat për mediat, të dhënat për përdorimin e mediave dhe besimin në media, dhe të dhënat për nivelin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe korrupsionin. Të dhënat në dispozicion janë nxjerrë nga burime parësore dhe dytësore.

Kuadri ligjor i Kosovës për qeverisjen e mediave nuk ka ndryshuar që nga viti 2012.

Disa informata kanë munguar në kohën e hulumtimit. Në veçanti, të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 nuk janë publikuar, me përjashtim të disa të dhënave të përgjithshme siç është numri i përgjithshëm i popullsisë. Të dhënat e fundit mungojnë gjithashtu në fusha të caktuara, veçanërisht për vlerën e tregut vendor të reklamave, pjesën e audiencës dhe konsumin e mediave. Të dhënat e sakta ishte e vështirë të gjindeshin në fushën e mirëqenies ekonomike të gazetarëve, prandaj niveli mesatar i të ardhurave në vend u mor si referencë për të ardhurat mesatare të gazetarëve. Në fusha të tjera, si niveli i demokracisë, perceptimi i korrupsionit, sundimi i ligjit dhe niveli i edukimit medial, për mbledhjen e të dhënave u përdorën raporte ndërkombëtare. Këto të dhëna janë të rëndësishme për analiza, diskutim publik dhe kërkime të mëtejshme kuantitative në fazën tjetër të projektit.

E ardhmja e mediave është temë relevante në Kosovë. Ligji për media, liria e shtypit, dezinformimi, edukimi medial, paditë strategjike kundër gazetarëve dhe fushatat e kërcënimeve dhe shpifjeve kundër profesionistëve të mediave po e nxisin diskutimin dhe hulumtimin mbi të ardhmen e mediave në Kosovë. Kuadri ligjor i Kosovës për qeverisjen e mediave nuk ka ndryshuar që nga viti 2012. Megjithatë Direktiva Evropiane e Shërbimit të Mediave Audiovizive u përditësua në vitin 2018, Kosova ende nuk ka arritur ta harmonizojë ligjin e saj për mediat. Një përpjekje u bë në vitin 2023 kur Qeveria e Kosovës miratoi projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (Kosova Sot Online, 2023); megjithatë, u ngritën shqetësime në lidhje me qartësinë ligjore, proporcionalitetin e masave dhe devijimin nga standardet evropiane (Këshilli i Evropës, 2024). Këshilli i Evropës publikoi një opinion ligjor mbi projektligjin që sugjeron se “qeverisja e mediave dhe komunikimit duhet të bazohet në prova që tregojnë nevojën për ndërhyrje, si dhe të marrë parasysh ndikimin e saj rregullator dhe të të drejtave të njeriut për të lejuar një përgjigje të graduar

dhe të diferencuar duke respektuar rolet e luajtura nga aktorë të ndryshëm në prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e përmbajtjes” (Këshilli i Evropës, 2024).

Sistemi i dyfishtë i rregullimit dhe vetërregullimit është ende në fuqi. Ndërsa autoriteti rregullator nacional, përkatësisht Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), ka juridiksion mbi mediat transmetuese, siç janë radioja dhe televizioni, mediat online vetërregullohen përmes Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Gati 260 media janë të licencuara nga KPM-ja, një rritje e madhe në krahasim me dhjetë vjet më parë. Janë krijuar kanale të reja televizive për shkak të rritjes së shpejtë të numrit të operatorëve kabllorë. Pa pasur nevojë për frekuenca transmetimi, kompanitë mediale u nxitën të krijojnë kanalet e tyre televizive. Kosova ka shënuar gjithashtu rritje masive të mediave online. Edhe pse nuk dihet numri i saktë i tyre, rreth 40 prej tyre janë anëtarë të KMSHK-së. Duke pasur parasysh gjuhët e larmishme në të cilat veprojnë mediat e Kosovës, pluralizmi i mediave, së bashku me transparencën e pronësisë së mediave, është rritur ndjeshëm në vend.

Pavarësisht rritjes së shpejtë të përdorimit të rrjeteve sociale në mesin e popullatës, televizioni mbetet burimi më i përdorur i lajmeve dhe informatave për qytetarët e Kosovës.

Pavarësisht rritjes së shpejtë të përdorimit të rrjeteve sociale në mesin e popullatës, televizioni mbetet burimi më i përdorur i lajmeve dhe informatave për qytetarët e Kosovës. Sipas një sondazhi të publikuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan, televizioni ka qenë burimi kryesor i informimit për tre vitet e fundit (Mehmeti, 2021). Megjithatë, ndryshimet janë të dukshme kur bëhet fjalë për shtrirjen e audiencës mes llojeve të ndryshme të mediave. Ndërsa shtrirja e audiencës së televizionit po bie, nga 82% (2021) në 61% (2024), shtrirja e audiencës së mediave sociale po rritet. Tre mediat sociale më të popullarizuara në Kosovë janë Facebooku 84%, Instagrami 74% dhe TikToku 14% (Instituti Ndërkombëtar Republikan, 2024). Ky hulumtim tregon se përderisa përdorimi i mediave është në rritje të vazhdueshme në mesin e qytetarëve të Kosovës, niveli i edukimit medial ka shkuar në drejtim të kundërt. Renditja e Kosovës në Indeksin Global të Edukimit Medial ka rënë për dy pozita nga viti i kaluar, nga 23 në 21 (Instituti i Shoqërisë së Hapur, 2023).

Hulumtimi mbi të ardhmen e mediave u krye njëkohësisht në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi, me qëllim identifikimin dhe analizimin e gjendjes aktuale dhe trendeve në zhvillim në media, gazetari dhe demokraci. Në pjesën e parë të hulumtimit, të kryer mes prillit dhe shtatorit 2024, një grup i madh i të dhënave mbi gazetarinë, peizazhin mediatik, pronësinë dhe financat, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e mediave, përdorimin e mediave, besimin në media dhe demokracinë u mbledhën dhe analizuan në nivel vendi. Trendet, rreziqet dhe mundësitë e identifikuara do të analizohen më tej përmes intervistave dhe grupeve të fokusit me aktorë të ndryshëm në pjesën e dytë të hulumtimit në vitin 2025, duke rezultuar në rekomandime për mbrojtjen

e gazetarisë, mediave dhe demokracisë. Hulumtimi është pjesë e projektit rajonal "Media jonë: Veprim i shoqërisë civile për të gjeneruar edukim medial dhe aktivizëm, për të kundërshtuar polarizimin dhe për të promovuar dialogun", i zbatuar nga nëntë organizata mediale nga Ballkani Perëndimor, Turqia dhe Sllovenia në periudhën 2023–2026.

Të dhënat faktike të paraqitura në tabelat në këtë raport janë vetëm pjesa e mbledhjes së gjerë të të dhënave të paraqitura në raportin e veçantë të të dhënave, në dispozicion në webfaqen e projektit Media jonë.¹

1 Linku në faqen e projektit Our Media: <https://seenpm.org/our-media-publications/>

II.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË VENDIT

Sipas të dhënave preliminare të regjistrimit të popullsisë, popullsia e Kosovës është 1,586,659. Kjo shifër tregon se popullsia është në rënie krahasuar me regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 kur Kosova kishte 1,739,825 banorë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2011). Regjistrimi i popullsisë u organizua nga Agjencia e Statistikave të Kosovës gjatë prillit dhe majit 2024. Deri më tani janë publikuar vetëm disa të dhëna preliminare dhe raporti përfundimtar do të publikohet në tremujorin e fundit të vitit 2024.

Ndërsa popullsia ka qenë në rënie, GDP-ja e Kosovës për kokë banori është rritur.

Ka pasur një parashikim të madh për të dhënat e regjistrimit të popullsisë, duke qenë se procesi ishte planifikuar të zhvillohej në vitin 2021, saktësisht dhjetë vjet pas regjistrimit të vitit 2011. Për studiuesit, të dhënat e vitit 2011 janë referencë e vjetëruar, veçanërisht për çështjet që lidhen me nivelet e edukimit. Andaj, raporti përfundimtar i regjistrimit të vitit 2024 do të zbulojë të dhëna të sakta për popullsinë e Kosovës, përfshirë pjesën e të rinjve, nivelin e arsimit formal, dhe shkallën e edukimit. Duke pasur parasysh statusin politik të Kosovës, si një shtet i ri që ende nuk është njohur në databaza të ndryshme ndërkombëtare, nuk ka të dhëna për shkallën e edukimit në Rishikimin Botëror të Popullsisë (2024).

Ndërsa popullsia ka qenë në rënie, GDP-ja e Kosovës për kokë banori është rritur. GDP-ja e Kosovës në vitin 2023 ishte 5,941 dollarë. Në mënyrë të ngjashme, paga mesatare në Kosovë është rritur gjatë tre viteve të fundit. Paga mesatare në vitin 2023 ishte 570 euro (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2023). Për shkak të mungesës së të dhënave të sakta për pagat mesatare të gazetarëve, paga mesatare në nivel vendi bëhet si referencë për pagat

mesatare të gazetarëve. Megjithatë, duhet të theksohet se paga mesatare në transmetuesin e shërbimit publik është më e lartë në krahasim me sektorin privat.²

Tabela 1: **TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË VENDIT**

Popullsia e përgjithshme në vitin 2023	Të dhënat preliminare të regjistrimit të popullsisë 2024: 1,586,659
Shkalla e edukimit të popullsisë në vitin 2023	2011: 96.15%
GDP-ja për kokë banori në vend në vitin 2023 (bazuar në fuqinë blerëse)	5,941 dollarë
Paga mesatare në vend në vitin 2023	570 euro

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024; 2011); Agjencia e Statistikave të Kosovës (2023); Banka Botërore (2023)

2 Një sondazh i organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në vitin 2023 mes anëtarëve të saj dhe gazetarëve joanëtarë nga Kosova tregon se bazuar në komentet e 212 të anketuarve, përfshirë individë nga sektori publik, privat, jofitimprurës dhe i pavarur, është gjetur se pagat janë rritur për 28 për qind. Në vitet e mëparshme, punëtorët e mediave kanë marrë kompensim deri në 350 euro. Megjithatë, një ndryshim i rëndësishëm ndodhi në vitin 2023 pasi 12 për qind e të anketuarve raportuan se fitonin deri në 350 euro, ndërsa shumica deklaruan se pagat e tyre shkonin deri në 600 euro. Një numër i vogël përmendi se paga e tyre tejkalonte 800 euro (Mulliçi dhe Morina, 2023).

III.

E ARDHMJA E GAZETARISË

Gazetarët në Kosovë janë të organizuar rreth Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK). AGK-ja është organizatë joqeveritare e kryesuar nga Bordi. Gazetarët e Kosovës, përfshirë reporterët, operatorët e kamerave dhe freelancerët janë anëtarë të AGK-së. AGK-ja aktualisht ka 720 anëtarë, përfshirë 30 freelancerë. Sipas databazës së AGK-së, 65% e anëtarëve të saj janë gazetare.

Numri i përgjithshëm i gazetarëve është rritur gjatë dekadës së fundit. Një arsye për këtë është rritja e shpejtë e mediave online, të cilat i kanë zëvendësuar plotësisht gazetatat e shtypura. Një faktor tjetër është se, krahasuar me dhjetë vjet më parë, ka të paktën tre universitete që prodhojnë të diplomuar në fushën e studimeve të mediave dhe komunikimit. Numri i përgjithshëm i studentëve aktualë të gazetarisë nuk dihet. Vetëm universiteti publik, gjegjësisht Universiteti i Prishtinës, numëron 250 studentë në Departamentin e Gazetarisë në vitin akademik 2023/2024. Të dhënat për numrin e studentëve të gazetarisë në dy kolegje të tjera private nuk janë publike.

Megjithëse AGK-ja përfaqëson interesat e gazetarëve të Kosovës, veçanërisht kur bëhet fjalë për sigurinë e tyre, nuk ka sindikatë të veçantë të gazetarëve që do të avokonte për të drejtat kolektive të punës së gazetarëve. Rreth Sindikatës janë të organizuar vetëm gazetarët e transmetuesit të shërbimit publik (Radio Televizioni i Kosovës – RTK), ku përfshihet edhe personeli tjetër i RTK-së. Gazetarët e RTK-së janë gjithashtu më të avancuar sa i përket të ardhurave nga paga, duke qenë se RTK-ja financohet pothuajse tërësisht nga buxheti i shtetit.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është i organizuar dhe aktiv, veçanërisht në avokimin për një mjedis më të sigurtë. Numri i sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë kërcënimet, frikësimet dhe sulmet fizike, është rritur në tre vitet e fundit. Vetëm në vitin 2023 ka pasur 74 incidente të tilla të regjistruara nga AGK-ja (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, 2024). Rastet e SLAPP-it janë raportuar edhe në Kosovë, por numri i saktë nuk dihet. Përmes AGK-së, gazetarët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore falas. Kryetari i Bordit dhe anëtarët e tjerë të bordit zgjidhen përmes një procesi të hapur dhe transparent. Si

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është i organizuar dhe aktiv, veçanërisht në avokimin për një mjedis më të sigurtë.

shoqatë profesionale e gazetarëve, AGK-ja nuk është e ndarë ose e polarizuar përgjatë linjave politike. Gjatë gjithë vitit organizohen disa trajnime, që u dedikohen gazetarëve të rinj, si dhe gazetarëve të karrierës.

Ekziston gjithashtu një Kod Etik, i cili përcakton standardet e gazetarisë dhe mediave. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), autoriteti rregullator nacional për mediat audiovizive, zbaton Kodin e tij të Etikës në televizion dhe radio, ndërsa Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës zbaton Kodin e tij të Etikës në gazetatat/mediat online. Megjithatë, ajo që mungon ende në Kodin e Etikës / standardet profesionale janë dispozitat që lidhen me standardet e fundit etike si teknologjia, të dhënat personale, rrjetet sociale dhe inteligjenca artificiale.

Këshilli i Mediave të Shkruara është organi i vetëm vetërregullues në nivel vendi. Ai ka 43 anëtarë dhe është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave nga publiku në lidhje me shkeljet e Kodit të Etikës nga gazetarët. Anëtarësimi në Këshillin e Mediave të Shkruara është rritur vazhdimisht gjatë viteve, gjë që është një zhvillim pozitiv për të ardhmen e mediave pasi rrit kompetencat dhe kapacitetet e organit vetërregullues. Në vitin 2023, Këshilli i Mediave të Shkruara shqyrtoi 165 ankesa (Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, 2023), gjë që tregon një rritje të numrit të përgjithshëm të ankesave në tre vitet e fundit. Në 21 raste, Këshilli i Mediave të Shkruara ka konstatuar shkelje të Kodit të Etikës në lidhje me ndalimin e nxitjes së urrejtjes. Në 62 raste të tjera janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës në lidhje me barazinë dhe paanshmërinë në raportim. Shkelje janë konstatuar nga organi rregullator nacional (KPM) për raportimin gjatë fushatës zgjedhore. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, në vitin 2021, KPM-ja konstatoi 18 shkelje të Kodit të Etikës gjatë periudhës së fushatës zgjedhore (Komisioni i Pavarur i Mediave, 2021).

Qasja në informata publike rregullohet me një ligj të veçantë dhe zbatohet nga një agjenci e veçantë. Ligji për Qasje në Dokumente Publike zbatohet nga Agjencia për Informim dhe Privatësi. Pavarësia dhe efikasiteti i organit përmbarimor ka çuar në rritjen e kërkesave për qasje në informata publike. Ky është një tregues pozitiv për të ardhmen e mediave dhe gazetarisë në Kosovë pasi mekanizmat ligjorë për qasje në informata publike po zbatohen në praktikë. Një tjetër ligj i rëndësishëm, Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, mbron burimet e gazetarisë dhe komunikimit. Përkundër mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarisë dhe mbrojtjes nga gjurmimi dhe vendosja e ndonjë softueri gjurmues në çfarëdo materiali, pajisje digjitale, makinë a mjet të përdorur prej tyre, ka pasur një raport nga një gazetar në lidhje me një pajisje gjurmuese të gjetur në makinën e tij, e cila e detyroi AGK-në të nxjerrë një deklaratë publike për të dënuar aktin (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, 2017).

Ekziston gjithashtu një Kod Etik, i cili përcakton standardet e gazetarisë dhe mediave. Komisioni i Pavarur i Mediave zbaton Kodin e tij të Etikës në televizione dhe radio, ndërsa Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës zbaton Kodin e tij të Etikës në mediat online.

Tabela 2: TË DHËNA PËR GAZETARËT DHE GAZETARINË

Numri i përgjithshëm i gazetarëve në vitin 2023	720
Numri i përgjithshëm ose përqindja e gazetarëve në vitin 2023	65%
Numri i studentëve të gazetarisë (dhe komunikimit dhe mediave) në vitin 2023/2024 në Universitetin e Prishtinës	250
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i studentëve të gazetarisë në rritje, në rënie apo mbetet i njëjtë?	Mbetet i njëjtë
Paga mesatare e gazetarëve në vitin 2023	570 euro
Numri i sulmeve ndaj gazetarëve (dhe mediave) në vend në vitin 2023 (përfshirë kërcënimet, frikësimet, fushatat e njollosjes, sulmet fizike)	74 sulme dhe shkelje të të drejtave të gazetarëve
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i sulmeve ndaj gazetarëve në rritje, në rënie ose mbetet i njëjtë?	Në rritje 2023: 74 2022: 33 2021: 29
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i ankesave në organin përkatës vetërregullues në nivel vendi në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Në rritje 2023: 165 2022: 104 2021: 129

Burimet: Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës; Departamenti i Gazetarisë i Universitetit të Prishtinës; Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (2023)

IV.

E ARDHMJA E MEDIAVE

4.1. KONCEPTI I MEDIAVE

Në korrik, Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj të ri për Komisionin e Pavarur të Mediave. Ky ligj, aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, ofron disa përkufizime për mediat, përfshirë mediat online dhe mediat e tjera që janë krijuar për shkak të avancimit të teknologjisë (Kuvendi i Kosovës, 2023). Përkufizime të tilla nuk ekzistojnë në Ligjin aktual për Komisionin e Pavarur të Mediave i cili u miratua në vitin 2012. Megjithatë, përkufizimi i ri i mediave dhe detyrimet ligjore që rrjedhin nga përkufizimi ligjor i mediave kanë qenë temë e debatit dhe kritikës publike gjatë gjithë vitit 2024. Këto përkufizime madje kanë qenë temë e një opinionit ligjor të lëshuar nga Këshilli i Evropës (2024). Për të ardhmen e mediave në Kosovë, kjo do të thotë se disa nga përgjegjësitë që aktualisht kryhen nga organi vetërregullues (KMSHK) do të jenë nën autoritetin e rregullatorit të mediave (KPM).

Tabela 3: TË DHËNAT PËR KONCEPTIN E MEDIAVE

Përkufizimi i mediave përcaktohet në rregulloren nacionale. PO/JO/Pjesërisht	PO
Përkufizimi/koncepti i detyrimeve mediale dhe ligjore që rrjedhin nga përkufizimi ligjor i mediave kanë qenë temë e debatit publik dhe argumenteve kontestuese. PO/JO/Pjesërisht	PO

4.2. PEIZAZHI MEDIAL

Numri i mediave në vend është rritur në tre vitet e fundit. KPM-ja ka 259 të licencuar, ku përfshihen televizionet, radiot dhe operatorët kabllorë. Ndër mediat e licencuara është Radio Televizioni i Kosovës, i vetmi transmetues i shërbimit publik i cili ka katër kanale televizive dhe dy radio stacione. Shumica e mediave janë media private, komerciale, edhe pse disa veprojnë edhe si media të OJQ-ve. Numri i rritur i mediave ka efekt pozitiv në pluralitetin e zërave dhe pluralitetin e burimeve të lajmeve. Megjithatë, qëndrueshmëria financiare do të jetë sfidë duke pasur parasysh tregun e vogël të reklamave në Kosovë.

Kosova nuk ka media të shtypura që nga viti 2020. Të gjitha gazetat e përditshme e ndalën shtypin gjatë pandemisë.

Kosova nuk ka media të shtypura që nga viti 2020. Të gjitha gazetat e përditshme e ndalën shtypin gjatë pandemisë. Rezultati i këtij trendi është shfaqja e portaleve të lajmeve të cilat në shumicën e rasteve publikojnë artikuj të shkurtër të lajmeve, pa shumë kontekst. Në planin afatgjatë kjo mund të ketë ndikim negativ në kulturën e prodhimit dhe leximit të raporteve të gjata të lajmeve dhe analizave hulumtuese. Numri i kanaleve televizive është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit; megjithatë, vetëm rreth 40 kanale televizive kanë përmbajtje lajmesh.³ Nga ana tjetër, nga 79 radio stacione që veprojnë në Kosovë, vetëm 4 radio stacione nacionale kanë lajme nacionale, ndërsa rreth 66 të tjera kanë përmbajtje rajonale ose lokale të lajmeve. Numri i saktë i mediave online është i panjohur; megjithatë, një mënyrë për të vlerësuar numrin e tyre është të shikohet numri i anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Organi vetërregullues aktualisht ka 43 anëtarë, të gjithë përfaqësues të mediave online.⁴

Përveç marrjes së fondeve të drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit, transmetuesit të shërbimit publik i lejohej të gjenerojë të ardhura edhe nga reklamat. Buxheti i përgjithshëm i RTK-së në vitin 2023 ishte 10.7 milionë euro, nga të cilat rreth 9 milionë euro erdhën nga buxheti i shtetit dhe 0.5 milionë euro nga reklamat (Radio Televizioni i Kosovës, 2024). Buxheti i RTK-së për vitin 2023 është pak më i lartë në krahasim me buxhetin e vitit 2022 prej 9.8 milionë euro, por dukshëm më i ulët në krahasim me buxhetin e vitit 2021 prej 12.2 milionë euro (Radio Televizioni i Kosovës, 2024). Mediat e pakicave, kanalet televizive dhe stacionet radiofonike në gjuhën e komuniteteve pakicë gjithashtu morën disa fonde nga Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit dhe organet lokale. Informatat mbi qëllimin, kriteret dhe vendimmarrjen janë në dispozicion të publikut. Ndarja e fondeve për mbështetjen e mediave nga donatorët ndërkombëtarë është gjithashtu në dispozicion, por shuma e saktë nuk dihet duke pasur parasysh natyrën e fondeve të tilla të shpërndara përmes projekteve të ndryshme.

3 Komisioni i Pavarur i Mediave, Databaza e mediave audiovizuale të Kosovës, <https://regjistri.kpm-ks.org/>

4 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Anëtarët, https://presscouncil-ks.org/?page_id=348&lang=en

Tabela 4: TË DHËNA PËR PEIZAZHIN MEDIAL

Numri i përgjithshëm i mediave në vend në vitin 2023	Rreth 260
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i mediave në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Nuk ka të dhëna për të gjitha mediat
Numri i përgjithshëm i mediave të shërbimit publik në vend (nacional, lokal) në vitin 2023	1 transmetues publik: 2 radio publike 4 kanale televizive publike
Numri i përgjithshëm i mediave private, komerciale në vend në vitin 2023	212 transmetues komercialë: 77 radio private 135 kanale televizive private (2024)
Numri i përgjithshëm i gazetave ditore në vend në vitin 2023	Asnjë
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i gazetave të përditshme në vend në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	N/A
Numri i përgjithshëm i kanaleve televizive nacionale me përmbajtje të lajmeve në vend në vitin 2023	40 vler.
Numri i përgjithshëm i radio stacioneve nacionale me përmbajtje të lajmeve në vend në vitin 2023	4
Numri i përgjithshëm i mediave online në vend në vitin 2023	43
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i mediave onilne në vend në rritje, në rënie ose mbetet i njëjtë?	Nuk ka të dhëna

Burimet: Komisioni i Pavarur i Mediave; Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

4.3. PRONËSIA E MEDIAVE

Transparenca e pronësisë së mediave dhe përqendrimi i mediave rregullohet nga një akt i veçantë nënligjor që u miratua në vitin 2023 nga Komisioni i Pavarur i Mediave (Komisioni i Pavarur i Mediave, 2023). Të gjitha mediat e licencuara janë të detyruara të zbulojnë informata në lidhje me pronarët e tyre. KPM-ja e vë këtë informacion në dispozicion të publikut përmes një platforme të qasshme për përdoruesit të quajtur Regjistri i Mediave⁵. Nëse numri i të punësuarve merret si referencë për madhësinë e mediave, atëherë është e sigurtë të thuhet se pronësia e mediave më të mëdha nuk ka ndryshuar në tre vitet e fundit. Në Kosovë lejohet pronësia e huaj, ku disa kanale televizive janë në pronësi të kompanive nga Shqipëria.

Tabela 5: TË DHËNAT MBI PRONËSINË E MEDIAVE

Emërtoni 3 pronarët më të mëdhenj të mediave në vend (pronarët e numrit më të madh të mediave dhe/ose me audiencën më të madhe dhe/ose pjesën më të madhe në tregun e reklamave). Shtoni informata rreth vendit të origjinës për secilin nga 3 pronarët më të mëdhenj të mediave.	Nuk ka të dhëna
TRENDI në 3 vitet e fundit: A ka ndryshuar lista e top 3 pronarëve të mediave në vend? PO/JO	Nuk ka të dhëna
Përqendrimi i pronësisë së mediave rregullohet në vend. PO/JO/Pjesërisht	PO
A rregullohet me ligj transparenca e pronësisë së mediave? PO/JO/Pjesërisht	PO
Pronësia e mediave është transparente në vend (publikohen informata të besueshme se kush është pronari i mediumit). PO/JO/PJESËRISHT	PO

Burimi: Komisioni i Pavarur i Mediave (2023)

5 Komisioni i Pavarur i Mediave, Databaza e mediave audiovizuale të Kosovës, <https://regjistri.kpm-ks.org/>

4.4. FINANCIMI I MEDIAVE

Mungojnë të dhënat e fundit në lidhje me vlerën e tregut nacional të reklamave. Një studim i IPSOS-it vlerësoi se vlera e tregut të reklamave në Kosovë në vitin 2018 ishte 15 milionë euro, nga të cilat 8.8 milionë euro shkuan për kanalet televizive, 2.27 milionë euro për mediat online dhe vetëm 0.69 milionë euro për radio stacionet (Mehmeti, 2020). Të dhënat përkatëse, të fundit dhe të verifikuara për burimet kryesore financiare siç është reklamimi janë të nevojshme për zhvillimin efektiv të tregut të mediave në Kosovë dhe për qëndrueshmërinë e mediave.

Tabela 6: TË DHËNA PËR FINANCIMIN E MEDIAVE

Vlera totale e tregut nacional të reklamave (përfshirë të gjitha llojet e mediave) në vitin 2023 në euro	2018: 15 milionë euro
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është vlera totale e tregut nacional të reklamave në rritje, në rënie, apo mbetet e njëjtë?	Nuk ka të dhëna
Pjesa e TV-së në vlerën e tregut nacional të reklamave në vitin 2023	2018: 8.8 milionë euro
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është pjesa e televizorit në vlerën e tregut nacional të reklamave në rritje, në rënie, apo mbetet e njëjtë?	Nuk ka të dhëna
Buxheti total i transmetuesit nacional të shërbimit publik për vitin 2023, në euro	10.7 milionë euro
TRENDI në 3 vitet e fundit: Buxheti i përgjithshëm i transmetuesit të shërbimit publik është në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Në rënie 2022: 9.8 milionë euro 2021: 12.1 milionë euro
Pjesa e buxhetit të përgjithshëm të transmetuesit nacional të shërbimit publik në vitin 2023 e marrë nga buxheti i shtetit	8.9 milionë euro
Shuma totale e financimit publik (grante dhe subvencione) nga qeveria dhe organet lokale për mediat në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është shuma totale e financimit publik (grante dhe subvencione) për mediat në vend në rritje, në rënie, apo mbetet e njëjtë?	Nuk ka të dhëna

Detyrimet e organeve, institucioneve dhe kompanive publike për të publikuar të dhëna për financimin e mediave rregullohen me ligj. PO/JO/Pjesërisht	PO
Të dhënat për shumat e alokuara të financimit publik për mediat publikohen. PO/JO/Pjesërisht	Pjesërisht
Sasia totale e reklamimit shtetëror (reklamimi i organeve shtetërore, institucioneve dhe kompanive shtetërore) në mediat në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është sasia totale e reklamave shtetërore në media në vend në rritje, në rënie, apo mbetet e njëjtë?	Nuk ka të dhëna
Shuma totale e financimit të donatorëve ndërkombëtarë për mediat në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është sasia totale e financimit të donatorëve ndërkombëtarë për mediat në vend në rritje, në rënie, ose mbetet e njëjtë?	Nuk ka të dhëna

Burimet: Mehmeti (2020); Radio Televizioni i Kosovës (2024)

4.5. PËRFAQËSIMI NË MEDIA

Numri i gazetareve në përgjithësi është më i madh se numri i gazetarëve. Për shkak të mungesës së të dhënave për 5 transmetuesit kryesorë televizivë, radio stacionet, mediat jofitimprurëse dhe mediat online, është e vështirë të vlerësohet numri i grave në pozita redaktoriale. Në lidhje me pjesën e grave dhe pjesën e personave nga pakicat etnike në organin drejtues të transmetuesit të shërbimit publik, ka katër gra dhe dy anëtarë me prejardhje nga pakicat etnike nga nëntë anëtarë, ndërsa në organin rregullator nacional ka vetëm një grua dhe vetëm një anëtar me prejardhje nga pakicat etnike nga një bord prej pesë anëtarësh. Sa i përket grupeve të pakicave, të gjitha komunitetet e njohura të pakicave etnike kanë një kohë specifike të caktuar në prodhimin e transmetuesit publik.

Tabela 7: TË DHËNAT MBI PËRFAQËSIMIN NË MEDIA

Përqindja e gazetarëve në vend në vitin 2023	65%
Përqindja e gazetarëve me prejardhje nga pakicat etnike në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
Përqindja e grave në mesin e kryeredaktorëve dhe menaxherëve të programeve të lajmeve të top 5 kanaleve televizive me përmbajtje të lajmeve në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
Përqindja e personave nën moshën 40 vjeç mes redaktorëve kryesorë të programeve të lajmeve dhe menaxherëve të top 5 kanaleve televizive me përmbajtje të lajmeve në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
Përqindja e personave me prejardhje nga pakicat etnike mes kryeredaktorëve të programeve të lajmeve dhe menaxherëve të top 5 kanaleve televizive me përmbajtje të lajmeve në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
Përqindja e grave në bordin e autoritetit rregullator nacional për mediat në vitin 2023	1 grua nga 5 anëtarë
Përqindja e personave me prejardhje nga pakicat etnike në bordin e autoritetit rregullator nacional për mediat në vitin 2023	1 person nga 5 anëtarë
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është numri i mediave të pakicave në vend në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Nuk ka të dhëna
Mediat e pakicave u mbështetën nga financimi publik në vitin 2023. PO/JO/ Pjesërisht	PO
Cilat komunitete të pakicave nuk shërbehen nga mediat e veta ose programet e pakicave në transmetimet e shërbimit publik nacional?	Të gjitha pakicat e njohura kanë kohë të ndarë në prodhimin e transmetuesit publik.

Burimi: Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës; Komisioni i Pavarur i Mediave; Radio Televizioni i Kosovës

4.6. Pjesëmarrja në media

Shumica e mediave në vend ofrojnë mekanizma për pjesëmarrje dhe ndërveprim me qytetarët, dëgjuesit ose shikuesit. Ndër tre mekanizmat më të zakonshëm të përdorur nga publiku për të marrë pjesë në media janë: komentimi në mediat sociale, mekanizmat e ankesave, ose nganjëherë duke folur drejtpërdrejt me mediat.

Tabela 8: TË DHËNAT MBI Pjesëmarrjen në media

Shumica e mediave në vend zakonisht ofrojnë mekanizma për pjesëmarrje dhe ndërveprim me qytetarët/lexuesit, dëgjuesit, shikuesit (seksionet e komenteve, letrat drejtuar redaktorit, forumet, blogët, redaktori i lexuesve, avokati i popullit, lloji tjetër i mekanizmit të ankesave, anëtarësimi, praktika, grupet e fokusit...). PO/JO/Pjesërisht	PO
TRENDI në 3 vitet e fundit: A po rritet, bie ose mbetet i njëjtë numri i mekanizmave për pjesëmarrje në media në vend (p.sh. seksionet e komenteve po mbyllen ose hapen, avokati i popullit po themelohet ose mbyllet, etj.)?	Mbetet i njëjtë.
3 mekanizmat më të zakonshëm të pjesëmarrjes (qytetare) në media në vend	Komentet në mediat sociale, mekanizmat e ankesave, vox pop

V.

E ARDHMJA E PËRDORIMIT TË MEDIAVE DHE BESIMI

5.1. PËRDORIMI I MEDIAVE

Sipas një sondazhi të vitit 2024 të publikuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan, televizioni është burimi më i përdorur i lajmeve dhe informacionit për qytetarët e Kosovës, i ndjekur nga mediat sociale (Instituti Ndërkombëtar Republikan, 2024). Trendi nuk ka ndryshuar në tre vitet e fundit, siç tregon një sondazh tjetër i vitit 2021 (Mehmeti, 2021). Megjithatë, ndryshimet janë të dukshme kur bëhet fjalë për shtrirjen e audiencës mes llojeve të ndryshme të mediave. Për shembull, një krahasim mes dy sondazheve tregon se shtrirja e audiencës së televizionit ka rënë nga 82% (2021) në 61% (2024). Arritja e audiencës së mediave sociale është mjaft e lartë (65% në vitin 2021). Facebooku 84%, Instagrami 74%, TikTok 14%, janë tre mediat sociale më të njohura aktualisht në Kosovë (Instituti Ndërkombëtar Republikan, 2024).

Facebooku
84%, **Instagrami**
74%, **TikTok**
14%, janë tre
mediat sociale
më të njohura
aktualisht në
Kosovë.

Sa i përket edukimit medial në vend, Kosova aktualisht ka një rezultat prej 21 në indeksin global, i cili shkon nga 0 në 100, ku rezultati më i lartë do të thotë edukimi më i lartë medial i popullsisë. I njëjti burim tregon se ka pasur rënie në Indeksin e Edukimit Medial në krahasim me vitin e kaluar, nga 23 në 21 (Instituti i Shoqërisë së Hapur, 2023). Indeksi i Edukimit Medial u zhvillua nga Instituti i Shoqërisë së Hapur – Sofje për të përfshirë 35 vende evropiane. Në vitin 2022, numri i vendeve u zgjerua në 41 vende në Evropë. Në fund të renditjes, Gjeorgjia zë vendin e fundit me 20 pikë, e paraprirë nga Kosova me 21 pikë në vendin e 40të, Maqedonia e Veriut me 23 pikë në vendin e 39të dhe Bosnja dhe Hercegovina me 24 pikë në vendin e 38të. Indeksi i Edukimit Medial merr parasysh tregues të ndryshëm si cilësia e arsimit, niveli i lirisë së mediave, besimi në njerëz dhe pjesëmarrja elektronike. Nga të gjithë treguesit, cilësia e arsimit mund të jetë faktori kryesor që ndikon në indeksin e ulët të edukimit medial të Kosovës. Në përgjithësi, mendohet se njerëzit që janë më të arsimuar janë më të informuar, janë mendimtarë më të mirë kritikë dhe kanë më pak të ngjarë të bien në grackën e lajmeve të fabrikuara (Instituti i Shoqërisë së Hapur, 2023). Rezultati i ulët i Kosovës në performancën e leximit në PISA flet për cilësinë e përgjithshme të arsimit në vend (OECD, 2023).

Tabela 9: TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E MEDIAVE

Cili lloj i mediave ishte burimi më i përdorur i lajmeve dhe informacionit për qytetarët në vend në vitin 2023?	Televizioni (2024)
TRENDI në 3 vitet e fundit: A ka ndryshuar lloji i mediave që është burimi më i përdorur i lajmeve dhe informacionit për qytetarët në vend? PO/JO Nëse po, nga cili lloj në cilin lloj?	JO
Cili lloj i mediave ishte burimi më i përdorur i lajmeve dhe informacionit për të rinjtë (mosha mes 15 dhe 29 vjeç) në vend në vitin 2023?	Nuk ka të dhëna
Arritja e audiencës së llojit të mediave "Televizioni" në vend në vitin 2023	61% (2024)
Top 3 mediat sociale më të popullarizuara (më të përdorura, më të vizituara) në vend në vitin 2023	Facebooku: 84% Instagrami: 74% TikToku: 14%
Top 3 mediat sociale më të njohura (më të përdorura, më të vizituara) në mesin e të rinjve (mosha mes 15 dhe 29 vjeç) në vend në vitin 2023	Facebooku Instagrami TikToku
Top 3 emisionet më të popullarizuara (më të shikuara) të lajmeve televizive në vend në vitin 2023	Nuk ka të dhëna
Indeksi i Edukimit Medial në vend në vitin 2023	Rezultati 21/100
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është Indeksi i Edukimit Medial në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Në rënie 2022: 23/100
Edukimi medial është lëndë e veçantë në shkollat fillore ose të mesme. PO/JO/ Pjesërisht	JO

Burimet: Instituti Ndërkombëtar Republikan (2024); Instituti i Shoqërisë së Hapur (2024)

5.2. BESIMI NË MEDIA

Kur bëhet fjalë për besimin në media, në përgjithësi qytetarët e Kosovës kanë besim të madh në media. Në mungesë të të dhënave më të fundit, mund t'i referohemi një sondazhi të IPSOS-it të vitit 2021, i cili tregon se niveli i besimit në media është 64%, ku televizioni ishte burimi më i besueshëm i mediave, i ndjekur nga rrjetet sociale dhe mediat online (Mehmeti, 2021). Megjithatë, besimi në media doli në vendin e 7të në një listë prej dhjetë institucioneve (Instituti Ndërkombëtar Republikan, 2024a). Një sondazh tjetër i opinionit, i kryer nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në vitin 2023, tregon se 3 institucionet më të besuara në Kosovë janë Kuvendi, Qeveria dhe Policia.⁶

Tabela 10: TË DHËNAT MBI BESIMIN NË MEDIA

Niveli i përgjithshëm i besimit në media në vend në vitin 2023 (në përqindje)	2021: 64% (përfshin edhe ata që kanë besim të plotë edhe ata që kryesisht kanë besim)
TRENDI në 3 vitet e fundit: A po rritet, bie ose mbetet i njëjtë niveli i përgjithshëm i besimit në media në vend?	Nuk ka të dhëna
Top 3 llojet më të besuara të mediave në vend në vitin 2023	Televizioni, rrjetet sociale, mediat online (2021)
TRENDI në 3 vitet e fundit: Rënditja e top 3 llojeve më të besuara të mediave në vend ka ndryshuar. PO/JO. Cilat lloje të mediave kanë ndryshuar vendet në mesin e 3 më të mirave?	Nuk ka të dhëna
Në cilin vend qëndrojnë mediat në renditjen e institucioneve më të besuara në vend në vitin 2023?	Vendi i 7të nga 10 vende
TRENDI në 3 vitet e fundit: Rënditja (vendi) e mediave mes institucioneve më të besuara në vend po rritet, po bie ose po mbetet e njëjtë?	Mbetet i njëjtë

Burimet: Mehmeti (2021), Instituti Ndërkombëtar Republikan (2024a)

6 Regional Cooperation Council, Balkan Public Barometer, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public>

VI.

E ARDHMJA E DEMOKRACISË

Pozicioni i Kosovës është përmirësuar edhe në Indeksin Global të Gjendjes së Demokracisë, nga vendi i 77të në vitin 2021 në vendin e 73të në vitin 2022 (Iniciativa Globale për Gjendjen e Demokracisë, 2023). Megjithatë, sondazhe të tjera tregojnë se niveli i besimit në gjyqësor është në rënie, nga 61% në 2022 në 45% në 2023 të njerëzve që besojnë plotësisht ose priren t'i besojnë gjyqësorit⁷. Megjithatë, një trend i lehtë në rritje është i dukshëm në Indeksin e Sundimit të Ligjit, nga 0.55 (2021) në 0.56 në vitin 2023 (Projekti i Drejtësisë Botërore, 2023). Trend pozitiv shihet edhe për sa i përket pjesëmarrjes së votuesve në dy zgjedhjet e fundit parlamentare, nga 44% në 2019 në 49% në 2021 (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2021). Në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, Kosova mbetet në të njëjtin pozicion në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 (Transparency International, 2023).

Në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, Kosova mbetet në të njëjtin pozicion në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Nga ana tjetër, është bërë përparim nga viti 2022 deri në vitin 2023 në Indeksin e Lirisë së Mediave, nga 67 në 68.38 sipas Reporterëve pa Kufij (2023). Një arsye për trendin pozitiv mund të jetë se legjislacioni që mbron lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave ndjek standardet ndërkombëtare dhe, në një masë të madhe, zbatohet në praktikë, veçanërisht kur bëhet fjalë për lirinë e publikimit të raporteve hulumtuese, në mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe në mbrojtjen e sinjalizuesve. Legjislacioni për zgjedhjet ndjek gjithashtu standardet ndërkombëtare. Megjithatë, pozicioni i përgjithshëm i renditjes konsiderohet ende 'problematic' në hartën globale të lirisë së mediave dhe një arsye për këtë mund të jenë kërcënimet në rritje ndaj gazetarëve.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2024 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përfshin nene për fushatat zgjedhore, është në përputhje me standardet e BE-së. Megjithatë, ky ligj ende nuk është testuar në praktikë pasi zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë planifikuar në shkurt 2025. Në Kosovë janë të garantuara edhe të drejta të tjera themelore, siç janë e drejta për tubim publik, e drejta për qasje në informata publike, e drejta për informim për shpenzimin e fondeve publike. Institucionet gjegjëse të pavarura dhe funksionale, si Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Agjencia për Informimin dhe Privatësinë, sigurojnë respektimin e këtyre të drejtave themelore.

⁷ Regional Cooperation Council, Balkan Public Barometer, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/publicn>

Tabela 11: **TË DHËNA PËR DEMOKRACINË**

Indeksi i Demokracisë së vendit në vitin 2023	Vendi i 73të në përfaqësim në Iniciativën Globale për Gjendjen e Demokracisë (Rezultati më i lartë është 0.88 (Suedia) i cili renditet si numri 1 në përfaqësim, dhe rezultati më i ulët është 00)
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është Indeksi i Demokracisë së vendit në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Në rritje 2022: 73 2021: 77
Cili është Indeksi i Sundimit të Ligjit të vendit në vitin 2023? (sipas Projektit të Drejtësisë Botërore)	0.56 (Indeksin maksimal e shënon Danimarka me 0.90, e cila renditet si numri 1 në Indeksin e Sundimit të Ligjit, ndërsa Kosova, me një indeks prej 0.56, renditet e 58ta)
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është Indeksi i Sundimit të Ligjit të vendit në rritje, në rënie, apo mbetet i njëjtë?	Në rritje 2023: 0.56 2022: 0.56 2021: 0.55
Niveli i Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vendin në vitin 2023	Rezultati: 41/100 Rezultati sillet nga 0 në 100 (0 shumë të korruptuar dhe 100 shumë të pastër)
TREND in the past 3 years: Is the Corruption Perceptions Index for the country growing, declining, or remaining the same?	Mbetet i njëjtë 2023: 41/100 2022: 41/100 2021: 39/100
Cili është Indeksi i Lirisë së Mediave në vend në vitin 2023?	68.38/100 (Rezultati më i lartë i indeksit do të thotë mjedis më i mirë për lirinë e mediave)
TRENDI në 3 vitet e fundit: A është Indeksi i Lirisë së Mediave në vend në rritje, në rënie apo mbetet i njëjtë?	Në rritje 2022: 67 2021: 69.68
A ka transparencë dhe qasje të hapur publike në të dhënat për shpenzimin e fondeve publike? PO/JO/Pjesërisht	PO
Legjislacioni për qasjen në informata publike ndjek standardet ndërkombëtare. PO/JO/Pjesërisht	PO

Ekziston një institucion i pavarur funksional dhe i besueshëm që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për qasjen në informata publike, përfshirë administrimin e ankesave në lidhje me qasjen e mohuar. PO/JO/ Pjesërisht	PO
A ka pasur anëtarë të qeverisë ose të parlamentit nën ndjekje penale për akuza për korrupsion ose akuza të tjera penale në vitin 2023? PO/JO	Nuk ka të dhëna
A lejon legjislacioni pronësinë e partive politike në media në vend? PO/JO/ Pjesërisht	JO

Burimi: Iniciativa për Gjendjen Globale të Demokracisë (2023); Projekti i Drejtësisë Botërore (2023); Reporterët pa Kufij (2023); Transparency International (2023)

VII.

PËRFUNDIME

Kosova gëzon një kuadër ligjor relativisht të mirë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave. Ligjet në lidhje me mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe qasjen në informata publike duket se janë në përputhje me standardet evropiane.

Numri i përgjithshëm i gazetarëve është rritur gjatë dekadës së fundit. Pagat e tyre gjithashtu janë përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme, megjithëse shkalla e inflacionit gjithashtu është rritur ndjeshëm. Numri i gazetarëve lidhet me rritjen e numrit të mediave të reja. Mediat online i kanë zëvendësuar plotësisht gazetatat e shtypura. Tre universitete të ndryshme nxjerrin të diplomuar në fushën e studimeve të mediave dhe komunikimit. Vetëm universiteti publik ka 250 studentë në Departamentin e Gazetarisë.

Një fushë që ka nevojë për përmirësim të ndjeshëm, megjithatë, është përmirësimi i aftësive të edukimit medial. Kosova aktualisht qëndron në fund të tabelës për rezultatin e Indeksit të Edukimit Medial. Cilësia e arsimit mund të kontribojë në aftësinë e brezave të rinj për t'u angazhuar në mënyrë kritike me mediat. E ardhmja e mediave dhe demokracisë në Kosovë varet edhe nga faktorë të tjerë. Përmirësime të rëndësishme në sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit janë të nevojshme për të siguruar perspektiva më të mira për të ardhmen e mediave dhe gazetarisë në Kosovë.

Një fushë që ka nevojë për përmirësim të ndjeshëm, megjithatë, është përmirësimi i aftësive të edukimit medial.

LITERATURA DHE BURIMET

Komisioni Qendror Zgjedhor. (2021). *Zgjedhjet për kuvendin e Kosovës 2021: rezultatet përfundimtare nga qnr statistikave të përgjithshme: zgjedhjet*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/1.Statistikat-e-pergjithshme-1.pdf>

Këshilli i Evropës. (2024). *Opinion ligjor i projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave*. Këshilli i Evropës. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://rm.coe.int/legal-opinion-on-the-draft-law-on-the-independent-media-commission-of-/1680afd33b>

Iniciativa Globale për Gjendjen e Demokracisë. (2023). *Renditja e Vendeve – Gjendja Globale e Demokracisë 2023*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://www.idea.int/gsod/2023/countries/>

Komisioni i Pavarur i Mediave. (2021). *Raport monitorimi: OSHMA-të gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Republikës së Kosovës 2021*. Komisioni i Pavarur i Mediave. <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikime/Raport%20Monitorimi%20-%20OSHMA-t%C3%AB%20gjat%C3%AB%20fushat%C3%ABs%20zgjedhore%20p%C3%ABr%20Zgjedhjet%20e%20parakoh%C3%ABshme%202021.pdf>

Komisioni i Pavarur i Mediave. (2023). *Rregullore për pronësinë dhe koncentrimin e të licencuarve të KPM-së*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20PRONESIN%20DHE%20KONC.E%20TE%20LIC%20TE%20KPM%20%202023.pdf>

Instituti Ndërkombëtar Republikan. (2024). *Sondazhi nacional i Kosovës*. Instituti Ndërkombëtar Republikan. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://www.iri.org/resources/national-survey-of-kosovo-may-2024/>

Instituti Ndërkombëtar Republikan. (2024a). *Sondazhi rajonal i Ballkanit Perëndimor: shkurt-mars 2024*. Instituti Ndërkombëtar Republikan. Marrë më 28 dhjetor 2024 nga <https://www.iri.org/resources/western-balkans-regional-poll-february-march-2024-full/>

Kosova Sot Online. (2023, 27 dhjetor). *Qeveria miraton këto projektligjesh në mbledhjen e fundit para Vitit të Ri - Kosova Sot, Kosova Sot Online*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://www.kosova-sot.info/lajme/701207/qeveria-miraton-keto-projektligjesh-ne-mbledhjen-e-fundit-para-vitit-te-ri/>

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024). Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://ask.rks-gov.net/Rekos>

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2011). [Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011: Rezultatet përfundimtare: të dhënat kryesore]. Agjencia e Statistikave të Kosovës Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://askapi.rks-gov.net/Custom/1e3a7bf9-377f-46fa-a66c-e0744f3712f2.pdf>

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2023). Treguesit kryesorë. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://ask.rks-gov.net/>

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2017). AGK dënon sulmin ndaj gazetarit Vehbi Kajtazi. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://agk-ks.org/lajmet/agk-denon-sulmin-ndaj-gazetarit-vehbi-kajtazi/>

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. (2024). *Prezantohet raporti vjetor për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve dhe indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://agk-ks.org/lajmet/prezantohet-raporti-vjetor-per-lirine-e-mediave-dhe-sigurine-e-gazetareve-dhe-indeksi-i-sigurise-se-gazetareve-ne-ballkanin/>

Mehmeti, J. (2021). *In Media We (Dis)Trust: Mapping Citizens' Concerns over Media in Kosovo*. SEENPM, Peace Institute and Kosovo 2.0. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga [Resilience-research-publication-3-Kosovo-English.pdf](https://resilience-research-publication-3-kosovo-english.pdf)

Mehmeti, J. (2020). *Sustainability of professional journalism in the media business environment of the Western Balkans: National data overview: Kosovo**. TACSO. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://smartbalkansproject.org/wp-content/uploads/2024/05/Sustainability-of-professional-journalism-in-the-media-business-environment-of-the-Western-Balkans-Kosovo.pdf>

Mulliçi, G., dhe Morina, L. (2023). *Kosovë – Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe indeksi i sigurisë së gazetarëve 2023*. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://agk-ks.org/publikime/treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-mediave-dhe-indeksi-i-sigurise-se-gazetareve-2023/#>

OECD. (2023). *PISA 2022 Results: Factsheets: Kosovo*. OECD. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga https://www.oecd.org/en/publications/pisa-2022-results-volume-i-and-ii-country-notes_ed6fbcc5-en/kosovo_1f99d575-en.html

Instituti i Shoqërisë së Hapur. (2023). *Indeksi i Edukimit Medial 2023*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://osis.bg/wp-content/uploads/2023/06/MLI-report-in-English-22.06.pdf>

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. (2023). Zgjidhjet: Ankesat. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga https://presscouncil-ks.org/?page_id=391&lang=en

Radio Televizioni i Kosovës. (2024). Pasqyrat Financiare: 31 dhjetor 2023. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://rtklive.com/sq/docs/archive/758.pdf>

Reporterët pa Kufij. (2023). *Indeksi i Lirisë së Mediave*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://rsf.org/en/index>

Transparency International. (2023). *Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2023*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://www.transparency.org/en/cpi/2023>

Banka Botërore. (2023). GDP-ja për kokë banori (në dollarë) – Kosovë. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=XK>

Projekti i Drejtësisë Botërore. (2023). *Indeksi i Sundimit të Ligjit*. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/global/2023/Kosovo/>

World Population Review. (2024). Shkalla e analfabetizmit sipas vendit 2024. Marrë më 25 dhjetor 2024 nga <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/literacy-rate-by-country>

BURIMET

Komisioni i Pavarur i Mediave. Baza e të dhënave e mediave audiovizuale të Kosovës. <https://regjistri.kpm-ks.org/>

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. www.agk-ks.org

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Anëtarët. https://presscouncil-ks.org/?page_id=348&lang=en

Regional Cooperation Council. *Barometri Publik Ballkanik*. <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/publicn>

Universiteti i Prishtinës, Departamenti i Gazetarisë

PËR AUTORIN

Jeton Mehmeti është hulumtues dhe ligjërues i specializuar në politikat e mediave. Studimet themelore i kreu në Universitetin Ndërkombëtar të Malajzisë në Kuala Lumpur, studimet master në Universitetin e Evropës Qendrore në Vjenë ndërsa aktualisht ndjek studimet e doktoraturës në Universitetin e Grazit në Austri. Nga viti 2010 deri në vitin 2022, ai kontriboi në raportet vjetore të IREX-it si autor vendor për Indeksin e Qëndrueshmërisë së Mediave dhe Barometrin Vibrant të Informacionit. Hulumtimet e tij përqendrohen në rregullimin e mediave, gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin. Mehmeti është ligjërues në Universitetin Amerikan në Kosovë (RIT) dhe ka shërbyer si Zëvendëskryetar i Rrjetit të Rregullatore të Shteteve të Mesdheut (MNRA) dhe Kryetar i Komisionit të Pavarur të Mediave të Kosovës.

ZGJERIMI I PEIZAZHIT MEDIAL, PËRKEQËSIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE DHE EDUKIMI I ULËT MEDIAL

E ardhmja e mediave në Kosovë – Fakte dhe trende

Ky publikim është rezultat i hulumtimit të ndërmarrë si pjesë e projektit **“Media jonë: Veprim i shoqërisë civile për të gjeneruar edukim medial dhe aktivizëm, për të luftuar polarizimin dhe për të promovuar dialogun”**. Seria e dytë e hulumtimit u zhvillua në kuadrin tematik të titulluar “E ardhmja e mediave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, duke u fokusuar, në vitin 2024, në mbledhjen dhe analizimin e fakteve dhe trendeve mbi mediat dhe demokracinë në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Turqi.

Projekti **“Media jonë: Veprim i shoqërisë civile për të gjeneruar edukim medial dhe aktivizëm, për të luftuar polarizimin dhe për të promovuar dialogun”** zbatohet bashkërisht nga nëntë organizata për zhvillimin e mediave nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Koordinator i projektit trevjeçar është Fondacioni Mediacentar Sarajevë. Partnerë në projekt janë Instituti Shqiptar i Medias në Tiranë; Bianet në Stamboll; Instituti Maqedonas për Media në Shkup; Instituti i Malit të Zi për Media në Podgoricë; Shkolla e Gazetarisë në Novi Sad; Instituti i Paqes në Lubjanë; Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në Prishtinë; dhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM).